



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 13383 prot.

Vlorë, më 11.08 2025

**PROJEKT-VENDIM**

**NR. DATE. 2025**

**“PËR DHËNIE TITULLI NDERI “QYTETAR NDERI I VLORES” Z. ALBERT MUSTAJ**

Bazuar në Nenin 8, pika 2, Neni 9, pika 1/1.1 shkronja "d", Nenin 25, pikat 2 dhe 4, Neni 54, shkronja "ç" dhe Neni 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Rregullores së Këshillit Bashkiak” të Vlorës për organizimin dhe funksionimin e tij, Propozimit të Klubit Shumësportesh “Flamurtari si edhe në Relacionin e paraqitur nga administrata e bashkisë;

**VENDOSI:**

1.T’i jepet titulli nderi “Qytetar Nderi i Vlorës” z. Albert Mustafaj, “Mjeshtër i Sportit”, për kontributin e tij të shquar dhe të vyer në fushën e sportit, veçanërisht në disiplinën e notit, për arritjet e tij sportive të dëshmuara, përfaqësimin dinjitoz të qytetit të Vlorës në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe për kontributin e vazhdueshëm në promovimin e sportit dhe të qytetit tonë.

2.Titulli i nderit do t’i dorëzohet z. Albert Mustafaj në një ceremoni solemne të organizuar nga Bashkia Vlorë dhe Këshilli Bashkiak i Vlorës, në një datë që do të përcaktohet nga Kryetari i Bashkisë.

3. Për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Ky Projekt- Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 13383 prot.

Vlorë, më 11.08 2025

**RELACION**

**MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR DHËNIE TITULLI NDERI “QYTETAR  
NDERI I VLORËS” Z. ALBERT MUSTAJ**

Para Këshillit Bashkiak të Vlorës

**Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,**

Në mbështetje të propozimit të Klubit Shumësportesh “Flamurtari”, ju paraqitet për miratim projektvendimi “Për dhënie titulli “Qytetar Nderi i Vlorës” Z. Albert Mustafaj, si shprehje e mirënjohjes për kontributin e tij të shquar në sportin e notit dhe përfaqësimin dinjitoz të qytetit tonë në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

**1. Jeta dhe karriera sportive**

Z. Albert Mustafaj ka lindur më 25 qershor 1961 në qytetin e Sarandës, por karrierën sportive e ka zhvilluar dhe e ka lidhur ngushtë me qytetin e Vlorës.

- Aktivitetin sportiv e nisi në vitet 1970–1980 me ekipin e pionierëve, ku theu rekordin e 100 m shpinë.
- Më pas u bashkua me ekipin e të rinjve të “Flamurtarit”, ku fitoi gara të rëndësishme në 100 m shpinë si dhe në stafetat 4x50 m dhe 4x100 m katër notime.
- Në ekipin e të rriturve, nën drejtimin e trajnerit Liro Kreshpa, garoi krah notarëve të njohur si Skerdilaid Shyti, Agim Levani, Tomor Dano, Veni Bodo dhe Hysni Troge.
- Në fund të viteve ’70 theu rekordin e 200 m katër notime me kohën 2’08”, shumë pranë rekordit kombëtar të asaj kohe, duke ndihmuar ekipin e “Flamurtarit” të shpallej rekordmen kombëtar në stafetat 4x100 m dhe 4x200 m stil i lirë.
- Si notar polivalent, garoi në disa disiplina: 100 m delfin, 100 m shpinë, 200–400 m të përzier dhe 200 m stil i lirë, ku shpesh është shpallur kampion kombëtar.

Karrierën e tij sportive e përmbylli në vitin 1986, në garën e fundit kombëtare të zhvilluar në pishinën e qytetit të Vlorës.

## 2. Vlerësime dhe tituj

- Titulli “Mjeshtër i Sportit”
- Certifikatë Mirënjohjeje nga Federata Shqiptare e Notit
- Certifikatë Mirënjohjeje nga Shoqata Kombëtare e Veteranëve të Notit
- Vlerësimi “Nderi i Sportit Vlorë”

## 3. Kontributi qytetar dhe profesional

Përveç arritjeve të tij sportive, z. Mustafaj ka ruajtur gjithmonë një lidhje shpirtërore dhe aktive me qytetin e Vlorës, duke ndjekur me interes zhvillimet në sportin e notit dhe duke dhënë mendime e sugjerime për rritjen e cilësisë, përzgjedhjen dhe motivimin e talenteve të reja.

Në fushën e sipërmarrjes, veçanërisht në sektorin e hoteleri–turizmit, ai ka promovuar potencialet dhe resurset e jashtëzakonshme të Vlorës, duke kontribuar në rritjen e imazhit të qytetit si destinacion turistik.

Në vlerësim të kontributit të tij si sportist i shquar, përfaqësues dinjitoz i qytetit të Vlorës në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe për përkushtimin e tij të vazhdueshëm ndaj zhvillimit të sportit dhe promovimit të qytetit, propozohet që:

Z. Albert Mustafaj, “Mjeshtër i Sportit”, të nderohet me titullin “Qytetar Nderi i Vlorës”.

**DREJTOR JURIDIK**

**Alban Mësonjësi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË

Nr. 9444 Prot.

Vlorë, më 08.08 . 2025

**VENDIM**

**Nr. 6 . Datë 08.08.2025**

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, pranë Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 08.08.2025, pasi shqyrtoi propozimin e kërkeses nr.37 Prot, datë 16.06.2025 të Klubit Shumesportesh “ Flamurtari “ :

**VENDOSI**


Të miratojë propozimet e paraqitura si më poshtë:

1. Vlerësim me titullin “**Qytetar Nderi**” “Z . Veni Bodo “
2. Vlerësim me titull “ **Qytetar Nderi** “ “ Z . Albert Mustafaj “

Ky Vendim ti përcillet Administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë, për procedurat e mëtejshme ligjore, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

**KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR**

**Bardhosh Gaçe**



9444  
16 06 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
KLUBI SHUMËSPORTËSH FLAMURTARI

Nr. 37 prot

Vlorë, më 16.06.2025

KËRKESË PËR SHPALLJEN "QYTETAR NDERI" TË Z. VENI BODO  
DHE Z. ALBERT MUSTAFAJ

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Vlorë ✓

Lënda: Propozim për shpalljen "Qytetar Nderi i Vlorës" të z. Veni Bodo dhe z. Albert Mustafaj

E nderuara Kryetare e Këshillit Bashkiak,  
Të nderuar anëtarë të Këshillit,

Në emër të Klubit Shumësportësh "Flamurtari", kemi nderin të paraqesim këtë kërkesë për shpalljen "Qytetar Nderi i Vlorës" të dy figurave të shquara të sportit shqiptar, z. Veni Bodo dhe z. Albert Mustafaj, si një akt nderimi për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në fushën e notit dhe përfaqësimin dinjitoz të qytetit të Vlorës në arenën kombëtare.

Z. Veni Bodo Sportist i përkushtuar dhe kontribues i rëndësishëm i notit vlonjat;

Veni Bodo u lind më 24 janar 1963, në qytetin e Vlorës. Fillimet në sportin e notit i ka të hershme kur vëllai i tij, Niko Bodo, merrte pjesë në ekipin e notit, së bashku me legjendat e kohës si Jani Hondro, Pavllo Kisi, Liro Kreshpa dhe vëllezërit Levani. Në moshën 7-vjeçare nisi rrugën si notar me ekipin e moshave, duke dalë kampion në Spartakiadë në garat 50 m, 100 m dhe 200 m stil i lirë. Rekordi i tij i parë u vendos te pionerët në katër notim, duke thyer një rekord kombëtar të mëparshëm.

Në moshën 13-vjeçare garonte njëkohësisht me pionerët, të rinjtë dhe të rriturit, duke spikatur për talentin dhe rezultatet e jashtëzakonshme.

Në vitin 1979, në Sarandë, ai theu rekordin e mbajtur nga notari i njohur Skerdilajt Shyti në 400 m stil i lirë me kohën 4'45", duke hyrë në histori si notari që përmbysi një nga rekordet më të vështira të kohës. Po atë vit fitoi edhe garat 100 m dhe 200 m stil i lirë dhe u shpall notari më i mirë i kampionatit.

Në karrierën e tij prej 12 vitesh me ekipin Flamurtari i Vlorës, ai theu shumë rekorde kombëtare, mori dhjetëra trofe, dhe vendosi rekorde ekipore në stafetat 4x100 m dhe 4x200 m.

U vlerësua me titullin Mjeshtër i Sportit dhe mbetet një emër i nderuar në historinë e Federatës Shqiptare të Notit.

Z. Albert Mustafaj – Sportist me kontribut të rëndësishëm dhe aftësi të dalluara në notin vlonjat

Albert Mustafaj lindi më 25 qershor 1961 në qytetin e Sarandës, por karrierën e tij e ndërtoi e zhvilloi në mënyrë të lavdishme në qytetin e Vlorës.

Fillimet e tij si notar datojnë në vitet 1970–1980 me ekipin e pionierëve, ku që në nisje



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KLUBI SHUMËSPORTËSH FLAMURTARI**

të karrierës theu rekordin e 100 metrave shpinë për pionierë. Më pas u bashkua me ekipin e të rinjve të Flamurtarit, ku fitoi garat 100 m shpinë, si dhe stafetat 4x50 m dhe 4x100 m katër notim.

Kaloi në ekipin e të rriturve nën drejtimin e trajnerit Liro Kreshpa, ku garoi krah notarëve të shquar si Skerdilajd Shyti, Agim Levani, Tomor Dano, Veni Bodo dhe Hysni Troqe.

Në fund të viteve '70 theu rekordin e 200 metrave katër notim me kohën 2'08", shumë pranë rekordit kombëtar të asaj kohe. Falë kontributit të tij, ekipi i Flamurtarit u bë rekordmen në stafetat 4x100 m dhe 4x200 m, duke thyer rekordin e ekipit kombëtar.

Mustafaj ishte notar polivalent, i cili garonte në shumë disiplina: 100 m delfin, 100 m shpinë, 200–400 m përzier, 200 m stil i lirë — ku shpesh u shpall kampion kombëtar dhe u vlerësua me medalje, certifikata mirënjohjeje dhe titullin Mjeshtër i Sportit.

Karrierën e tij si sportist e mbylli në vitin 1986, në garën e fundit kombëtare në pishinën e qytetit të Vlorës.

Duke vlerësuar maksimalisht kontributin historik të këtyre dy sportistëve të shquar, dhe trashëgiminë e tyre sportive që nderon qytetin tonë, propozojmë shpalljen e tyre me titullin “Qytetar Nderi i Vlorës”.

Dokumentacioni bashkëlidhur kësaj kërkesë përfshin:

1. Curriculum Vitae të z. Veni Bodo
2. Curriculum Vitae të z. Albert Mustafaj
3. Kopje të certifikatave, vlerësimeve dhe titujve të marra gjatë karrierës së tyre sportive

Me respekt të veçantë,  
Klubi Shumësportësh “Flamurtari”

DREJTOR

Elona HASANAJ



INFORMACION  
PERSONAL

Albert Mustafaj

 Lagjia "28 Nentori", Rruga Veledin Kollozi +355 68 2773503 [Mustafajalbert1@gmail.com](mailto:Mustafajalbert1@gmail.com)**Gjinia** Mashkull | **Datëlindja** 25.06.1961Jeta e hershme dhe karriera

Jam lindur në 25 Qershor të vitit 1961 në qytetin e Sarandës aty ku nisi dhe karriera ime si notar me ekipin e Pionierëve gjatë viteve 1970-1980, ku që në fillim të karrierës thyej rekordin e 100 metrave shpinë për pionierë. Pas thyerjes së këtij rekordi, kaloj me ekipin e të rinjve tek Flamurtari duke dalë kampion në garat 100 metra shpinë dhe 4-50 dhe 4-100 katërnitim. Më pas kaloj me ekipin e të rriturve nën drejtimin e Z.Liro Kreshpa ku bënin pjesë shumë notarë ekselent si Skerdilajd Shyti Agim Levani. Tomor Dano. Veni Bode. Hysni Troqe.

Në fund të viteve 70 thyej rekordin e 200 metrave katërnitim, stil i lirë 2,08 kur rekordi ishte 2,07,5.

Fal dhe kontributit tim ekipi i Flamurtarit bëhet rekordmen i stafetës 4,100 - 4,200 metra stil i lirë që në atë periudhë mbahej si rekord nga Ekipi Kombëtarë. Gjatë karrierës time kam arritur normat e Mjeshtrit të Sportit në shumë gara. Nga trajnerët e asaj kohe jam cilësuar si një notar polivalent duke konkuruar në gara 100 m delfin dhe shpinë në nivelet e kohëve rekord të këtyre garave. Gjatë karrierës sime si notar shpallëm shumë herë kampion kombëtar në 200 m stil i lirë duke arritur të larta në 100-200 m stil i lirë, 100 m delfin, 200 e 400 m përzier, ku jam vlerësuar me medalje të ndryshme dhe Çertifikata vlerësimi, Mjeshtër Sport dhe mirënjohjeje për arritjet e mia në sportin e Notit.

Në vitin 1986 në pishinën e qytetit të Vlorës, mbyll karrierën me garën e fundit kombëtare.

# Çertifikatë Mirënjohje

Shoqata Kombëtare e Veteranëve të Notit nderon

Z./Znj. Albert Mustafaj

Për kontributin e shquar dhe cilësor në zhvillimin dhe forcimin e sportit të notit në Shqipëri nëpërmjet arritjeve të rezultateve të larta sportive, duke shërbyer si model pozitiv i brezave.

**Organizatorët:**

Sadik Mema

Dritan Mezin



TE STELA  
Sport & Estetikë

# Diplomë

I JEPET... Albert... Mustafari... QË ZURI VENDIN  
...I... NË GARËN... 25.04.2018... ME KOHË... 12.58.

DATE 11.1.2018

ADMINISTRATORJA  
"TE STELA"



TE STELA  
**Sport & Estetikë**

# Diplomë

I JEPET..... *ALBERT MUSTAFARAJ*..... QË ZURI VENDIN  
*I*..... NË GARËN *50m 3. lire*..... ME KOHË *30:90*.....

DATE *08.04.2012*.....

ADMINISTRATORJA  
"TE STELA"

Shoqata Kombëtare



e Veteranëve të Notit

## Diplomë

**Shoqata Kombëtare e Veteranëve të Notit**

Zikuj: ALBERT MUSTAFARAJ

I klasifikuar PARE

në garën 50m St. Lire me kohën 34.88

Aktiviteti: Takimi i Mirënjohjes "Gjithmonë Kampion"

**Organizatorët:**

Sadik Mema

Dritan Mezini

Shoqata Kombëtare



e Veteranëve të Notit

## Diplomë

**Shoqata Kombëtare e Veteranëve të Notit**

ZIJË ALBERT MUSTAFARAJ

I klasifikuar PARE

në garën 100m 4 Notit me kohën 1.25.45

Aktiviteti: Takimi i Mirënjohjes "Gjithmonë Kampion"

**Organizatorët:**

Sadik Mema

Sadik Mema

Dritan Mezini

Dritan Mezini

Tiranë, 18 Maj 2019

# CERTIFIKATË

— MIRNJOHJEJE —

## KUPA "SULEJMAN PODA"

I JEPET Z/ZNJ

*Albert Mustafaj*

Te Stela Sport Center

TIRANË 10.12.2022

Sadik Mema  
Kryetar i SHKVN

Shoqata Kombëtare



Agim Çiraku  
President i FSHN





TE STELA  
Sport & Estetikë

# Diplomë

I JEPET.....Albert.....Mustafaj..... QË ZURI VENDIN  
.....NË GARËN...23.04.2012.....Delfina.....ME KOHË...15"29.

DATE 11.12.2011.

ADMINISTRATORJA

"TE STELA"



TE STELA  
**Sport & Estetikë**

# Diplomë

I JEPET.....*Albert*.....*Mustafaj*.... QË ZURI VENDIN  
...II...NË GARËN...*25.11.2014*...*SH.P.UE*...ME KOHË...*15"89*..

DATE *11.1.12.12.14.*

ADMINISTRATORJA  
"TE STELA"